



E enjte, 14 prill 2011

NJOFTIM PËR MEDIA

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), në takimin e mbajtur sot më 14 prill 2011, ka vendosur që tarifat e energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar, të cilat do të zbatohen nga data 1 prill 2011, të mbesin të njëjta me ato të vitit të kaluar.

Në këtë takim Bordi ka shqyrtuar aplikacionet e Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a. (KEK) dhe të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe të Tregut të Kosovës sh.a. (KOSTT), komentet e marra nga palët e tjera të interesit dhe propozimin përfundimtar për tarifat e reja.

Bordi ka aprovuar propozimin përfundimtar të ZRRE-së për nivelin e të Hyrave të Lejuara për KEK-un dhe KOSTT-in, përkatësisht tarifave, pasi që komentet e pranuar nuk kanë ofruar ndonjë argument që do të ndikonte në ndryshimin e propozimit paraprak të ZRRE-së.

Ky është shqyrtimi i pestë me radhë i tarifave të energjisë elektrike dhe nënkupton vlerësimin e të Hyrave të Lejuara të KEK-ut dhe të KOSTT-it që duhet të mblidhen nga tarifat e energjisë elektrike nga konsumatorët e rregulluar.

Aplikacionet e kompanive, komentet e palëve të interesit, dokumentet e shqyrtimit të ZRRE-së si dhe tarifat e reja të energjisë janë të publikuara në faqen elektronike të ZRRE-së: www.ero-ks.org